

VENDIM
Nr. 165, datë 21.3.2018

PËR METODOLOGJINË E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË VEPRIMTARISË
KËRKIMORE-SHKENCORE TË NJËSIVE BAZË TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË
LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Miratimin e metodologjisë së procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë, mbështetur në kriteret e vlerësimit, të përcaktuara në këtë vendim.

2. Kriteret e vlerësimit të njësive bazë përfshijnë një listë treguesish që përlllogariten sipas kontributit katërvjeçar të njësive bazë në fushën e kërkimit shkencor, vlerësim i cili realizohet sipas një sistemi pikëzimi, të miratuar me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Njësitë bazë të institucioneve të arsimit të lartë, për efekt të procesit të vlerësimit, grupohen sipas fushave e nënfushave kryesore natyrore, inxhinierike e teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale e humane, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, llojeve të IAL-ve, formës së organizimit, publike apo jopublike, si dhe sipas veprimtarisë kryesore të departamenteve, qendrave kërkimore-shkencore apo qendrave studimore ndërdisiplinore.

4. Procesi i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë realizohet çdo katër vjet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

a) Kriteri bibliometrik:

i) Lista e artikujve të botuar në revista ndërkombëtare shkencore me faktor impakti, si dhe në revista akademike ndërkombëtare të indeksuara dhe të recensionuara;

ii) Lista e artikujve të botuar brenda vendit në revista shkencore dhe buletine shkencore të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

iii) Lista e monografive shkencore të botuara në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës, të vlerësuara si punime shkencore nga njësia bazë;

iv) Lista e monografive shkencore të botuara brenda vendit, të vlerësuara si punime shkencore nga njësia bazë;

v) Lista e kapitujve të librave akademikë, të redaktuar, të recensionuar dhe të botuar në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës dhe të vlerësuar si punime shkencore nga njësia bazë;

vi) Lista e kapitujve të librave akademikë, të redaktuar, të recensionuar dhe të botuar brenda vendit, si dhe të vlerësuar si punime shkencore nga njësia bazë.

b) Kriteri i impaktit të veprimtarisë kërkimore-shkencore:

i) Lista e patentave apo e shpikjeve të regjistruara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale apo autoriteteve të huaja;

ii) Lista e projekteve kërkimore-shkencore të fituara nga programet kuadër të BE-së për kërkim shkencor, si koordinator projekti ose si partner në projekt;

iii) Lista e sipërmarrjeve të reja, të krijuara si rezultat i punës kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë;

iv) Lista e kontratave të shërbimit me objekt studimor.

c) Kriteri infrastrukturor:

i) Lista e laboratorëve shkencorë të akredituar ose jo;

ii) Lista e bibliotekave të profilizuara dhe kapaciteti fizik i tyre, i shprehur në vende/poste pune-kërkimi;

iii) Lista e arkivave dhe e koleksioneve shkencore;

iv) Lista e abonimeve në revista apo e botimeve shkencore periodike, përshtirë dhe ato elektronike.

ç) Kriteri i kapaciteteve njerëzore:

i) Lista e personelit akademik të njësive bazë, me tituj akademikë: “profesor”, “profesor i asociuar”, “lektor” dhe “asistent lektor”, me kohë të plotë, në momentin e deklarimit;

ii) Lista e konferencave shkencore ndërkombëtare, të organizuara nga njësia bazë në bashkëpunim me homologët e saj, në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;

- iii) Lista e konferencave shkencore kombëtare të organizuara nga njësi bazë;
- iv) Lista e pjesëmarrjes së personelit akademik të njësisë bazë, me referime shkencore, në konferenca shkencore ndërkombëtare në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;
- v) Lista e pjesëmarrjes me referime shkencore të personelit akademik të njësisë bazë në konferenca shkencore kombëtare;
- vi) Lista e çmimeve ndërkombëtare shkencore të fituara nga personeli akademik i njësisë bazë në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;
- vii) Lista e çmimeve kombëtare shkencore të fituara nga personeli akademik i njësisë bazë;
- viii) Lista e programeve të “master ekzekutiv”, “specializime afatgjata në mjekësi” dhe “doktoratë”;
- ix) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore të revistave shkencore periodike në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;
- x) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore për botime shkencore joperiodike në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;
- xi) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore të revistave shkencore vendëse, të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- xii) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore për botime shkencore joperiodike vendëse;
- xiii) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, anëtarë të komiteteve shkencore të konferencave shkencore ndërkombëtare, të organizuara në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës;
- xiv) Lista e recensuesve nga personeli akademik i njësisë bazë për artikuj shkencorë të botuar në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës.

d) Kriteri i ndërkombëtarizimit:

- i) Lista e studimeve dhe e kërkimeve lëndore ose ndërdisiplinore të aplikuara me partner të vendeve të OECD-së dhe BE-së/të tjerë;
- ii) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, të angazhuar në institucionet e arsimit të lartë të vendeve të OECD-së dhe BE-së, e matur person/në javë;
- iii) Lista e personelit të huaj akademik të njësisë bazë nga vendet e OECD-së dhe BE-së, të ftuar pranë njësisë bazë, e matur person/në javë;
- iv) Lista e programeve të studimit për “master i shkencave” dhe të ciklit të tretë, të përbashkëta me IAL-të e huaja nga vendet e OECD-së dhe të BE-së, që përfundojnë me lëshimin e një diplome të përbashkët ose të dyfishtë.

5. Vlerësimi për çdo tregues që përbën kriteret e vlerësimit, në nivel njësi bazë, realizohet nëpërmjet një sistemi pikëzimi algoritmik, në mënyrë automatike nga platforma elektronike, Sistemi i Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor - ACRIS.

6. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit organizon, administron, monitoron dhe publikon rezultatet e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucioneve të arsimit të lartë.

7. Institucioni i arsimit të lartë, pas marrjes së njoftimit nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, njofton dhe vendos afate për personelin akademik të njësisë bazë, që të realizojnë procesin përkatës të plotësimit të të dhënave të kërkuara, në portalin “Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore”, në platformën ACRIS.

8. Drejtuesi i njësisë bazë udhëzon, monitoron dhe ndjek të gjitha vetëdeklarimet e të dhënave të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucionit të arsimit të lartë, duke kërkuar nga të gjithë anëtarët e njësisë përgjegjshmëri në plotësimin e informacionit, sipas kriterëve të përcaktuara, në portalin “Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore”.

II. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE GJATË PROCESIT TË VLERËSIMIT

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit janë si më poshtë:

- a) Të organizojë dhe të administrojë procesin e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucionit të arsimit të lartë, nëpërmjet portalit “Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në Shqipëri”;
- b) Të njoftojë institucionet e arsimit të lartë, nëpërmjet manualeve elektronike dhe të shkruara, për mënyrën e regjistrimit të të dhënave nga njësi bazë në sistem, për afatet e plotësimit të formularëve të vlerësimit *online* e të tjera;
- c) Të publikojë raportin përfundimtar të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucioneve të arsimit të lartë dhe renditjen e tyre, në formë elektronike dhe të printuar.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë bazë dhe të drejtuesve të njësive kryesore në institucionet e arsimit të lartë gjatë procesit të vlerësimit janë si më poshtë:

- a) Të caktojë një person kontakti brenda njësisë bazë që ndjek procesin e realizimit në afat të vlerësimit;
- b) Të koordinojë, të monitorojë dhe të ndjekë procesin e hedhjes së të dhënave nga personeli akademik i njësive bazë të IAL-ve, brenda afatit të përcaktuar.

III. ORGANIZIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT

1. Anëtarët e personelit akademik të njësisë bazë do të kenë akses individual të përdoruesit të kodifikuar dhe të mbrojtur, për vetëdeklarimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të drejtimeve kryesore të fushave të kërkimit dhe të disiplinave specifike.

2. Drejtuesi i njësive bazë ka akses individual të përdoruesit të kodifikuar dhe të mbrojtur që shërben për ndjekjen dhe monitorimin e të dhënave të deklaruara nga anëtarët e personelit akademik të njësive bazë.

3. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit është përgjegjëse në bashkëpunim me Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar për administrimin e portalit “Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore”, sigurimin dhe ruajtjen e të dhënave të publikuara, zbatimin standardeve të përgjithshme të vlerësimit dhe certifikimin e rezultateve të vlerësimit.

IV. PLATFORMA *ON-LINE* ACRIS – ALBANIA CURRENT RESEARCH INFORMATION SISTEM–PLATFORMA *ON-LINE* E SISTEMIT SHQIPTAR TË INFORMACIONIT TË KËRKIMIT SHKENCOR

1. Për vlerësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë krijohet platforma e Sistemit Shqiptar të Informacionit të Kërkimit Shkencor-ACRIS, e cila shërben si bazë kombëtare të dhënash për kërkimin shkencor, sipas përcaktimeve të nenit 13, të ligjit nr. 87/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të realizuara mbi bazën e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë.

2. Në bazë të të dhënave të hedhura në sistemin ACRIS nga njësitë bazë të institucioneve të arsimit të lartë, vlerësimi gjenerohet me pikë, automatikisht nëpërmjet algoritmit kompjuterik të sistemit të pikëzimit, për çdo kriter e indikator të përcaktuar në këtë vendim.

3. Në bazë të këtij sistemi vlerësimi, njësitë bazë të institucioneve të arsimit të lartë renditen brenda së njëjtës fushë kërkimi dhe në bazë të IAL-ve, si dhe hartohet raporti përfundimtar që i përcillet Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Njësitë bazë të institucioneve të arsimit të lartë, që i nënshtrohen procesit të vlerësimit, brenda dhjetorit 2019, plotësojnë dhe vetëdeklarojnë në platformën ACRIS veprimtarinë e tyre kërkimore-shkencore, sipas treguesve të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.

2. Procesi i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë fillon jo më vonë se muaji tetor 2019.

3. Urdhri i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për sistemin e pikëzimit të treguesve, që përbëjnë kriteret e metodologjisë së vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë miratohet brenda muajit maj 2018.

4. Kriteret dhe procedurat për vlerësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë për institucionet e arsimit të lartë me drejtim ushtarak, policor, artistik dhe sportiv, përcaktohen me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet e arsimit të lartë, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe Rrjeti Akademik Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

SHTOJCA 1
KLASIFIKIMI I FUSHAVE DHE I NËNFUSHAVE TË KËRKIMIT SHKENCOR

Nr.	Fushat kryesore	Nënfusha
1	Shkenca të natyrës	Matematikë dhe Informatikë
		Fizikë
		Kimi
		Shkenca të tokës
		Biologji
2	Shkenca inxhinierike dhe teknologjike	Inxhinieria mekanike, elektrike ekonomike, materiale, fizike, navale, tekstil
		Inxhinieri e teknologjisë së informacionit, Inxhinieri matematike
		Inxhinieri e ndërtimit, mjedisit, Arkitektura
		Inxhinieri e gjeologjisë, minierave
3	Mjekësia	Mjekësi, Farmaci, Stomatologji, Shkenca teknike mjekësore
4	Shkenca sociale dhe humanitare	Shkenca politike dhe sociale
		Histori, Filozofi, Pedagogji, Psikologji
		Shkenca juridike
		Shkenca të antikitetit, filologjisë, letërsisë
		Ekonomi dhe Statistikë
5	Shkenca bujqësore	Bujqësi
		Veterinari